



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**KËSHILLI I BASHKISË**  
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 1132 / Prot.  
8

Patos, më 28/05 2024

**PROCESVERBALI I TAKIMIT 20 MAJ 2024**

**Vendi:** "Salla e mbledhejeve të Njesisë Administrative Zharrëz "

**Ora e fillimit :** 10:00

**Ora e mbarimit :** 12:00

**Dëgjese publike me temë:** "Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025".

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

**Pjesëmarrës:** Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos Drejtore e Financës në bashki znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtore e Urbanistikës dhe Shërbimeve znj. Ermenita Mici, dhe rreth 30 pjesëmarrës (*Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe fermerë të njesisë Zharrëz*)

**Takimin hapet nga Sekretare e Këshillit: znj. Refaela Xeba.**

**Sekretare e Këshillit: znj. Refaela Xeba:-** Të nderuar pjesëmarrës më lejoni së pari t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me temë: **Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin**

**2025**". i cili bazohet në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025". Fjala është për ekzekutivin për të na paraqitur se cilat nga kërkesat tuaja gjatë muajit prill 2024, janë marrë parasysh për buxhetin afatmesëm 2025-2027



**Sekretare e Këshillit  
znj. Refaela Xeba**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025".**

**Maj 2024**

**Krytari i bashkisë z. Fation Duro:** - Të nderuar të pranishëm në radhë të parë më lejoni t'ju falenderoj për prezencën tuaj në këtë fazë dëgjesash. Rruga e varrezave ka filluar për shtrimin me çakull dhe këtë javë do të fillojnë rrugët me asfalt dhe do të vazhdojmë me kanalizimin e ujrave të zeza. Sot kemi filluar me rrugët e parcelave me shtrimin me çakull si dhe pastrimin e kanaleve dhe besoj se brenda javës mund të përfundojnë si punime. Pas rrugëve me çakull do të fillojmë me shtrimin me asfalt që janë tre ose katër rrugë që janë në njësinë Zharrëz ku disa janë shtruar dhe disa janë bërë gati për shtrimin e tapetit të asfaltit. Do të mbyllim një pjesë të KUZ-



**Krytari i bashkisë  
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025".**

**Maj 2024**

së në fshatin Verbas duke shtrirë gamën e këtij shërbimi edhe në zonat e tjera të njësisë. Për vitin tjetër do planifikojmë edhe ndërhyrjen për KUZ-në në fshatin Belinë dhe për realizimin e këtij investimi sot jemi në fazën e studimit për fshatin Verbas. Fshati Frashër ka probleme por jo kaq të theksuara sa në Verbas dhe Belinë. Rrugët do të shtyhen pak në kohë kjo për efekt të investimit të ujësjelësit dhe besoj se në muajin gusht sipas operatorit që kryen punimet do të fillojmë në njësinë Zharrëz për të vazhduar më pas në njësinë Ruzhdie. Si afat përfundimi i ujësjellësit është qershori i vitit që vjen por ata pretendojnë që ta përfundojnë përpara afatit. Lidhur mbi pjesën e vaditjes do të bëhen dy stacione të reja pompimi në Sheqishte që do të marrin ujë nga Belina dhe vija e ngjalës ku do të vendosim edhe matës për konsumin e ujit që do të konsumohet ndërsa për çmimin e tij do ta diskutojmë në një moment të dytë se sa do jetë për m<sup>3</sup> ose Ha, ku do të ketë edhe një grafik dhe do të shohim si do të eci si proces dhe nëse rezulton i sukseshëm do t'a ofrojmë këtë shërbim në të gjithë njësinë. Jemi duke përfunduar blerjen e bazës materiale për ndërhyrjet që do të bëhen te të gjitha varrezat publike me rrethimin e tyre, vendosjen e portave si dhe uji. Në fshatin Sheqishte do të bëhet rrethimi me mur kurse te varrezat e tjera rrethimi do të bëhet me rjetë teli por atje ku ka mundësi do të bëhet edhe trotuar. Në fshatin Belin do të hapen dy deri në tre km kanal vaditës. Në fshatin Zharrëz filloj puna por ishim të detyruar ta ndërprisnim punimet këtu pasi mjete duhet të kalonte në Patos dhe pas përfundimit të punës atje do të kthehet përsëri në njësinë Zharrëz. Pak a shumë këto janë ato se çfarë kemi parashikuar për investim në njësinë tuaj. Tani fjala është për ju nëse keni ndonjë kërkesë tjetër.

**Banor i njësisë Zharrëz z. Agim Djelli:-** Rruga në njësinë Zharrëz ka nevojë për ndërhyje pasi është shumë problematike. Kërkoj që të projektohet një magazinë për grumbullimin e prodhimit



**Banor i njësisë Zharrëz  
z. Agim Djelli**

**Dëgjesë publike me temë:**


**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

ndërsa për parcelat të bëhen puse për vaditje dhe kanalet që janë pronë e shtetit të pastrohen por ku do hidhet dheu. A e keni menduar?

**Krytari i bashkisë z. Fatjon Duro:** - Patjetër që kanalet kulluese po vazhdojnë të pastrohen dhe dheu do të hidhet në bankinën e kanallit.

**Banor i fshati zharrëz z. Barjam Hazizaj:-** Kërkoj të vazhdoj shtrimi i rrugëve të brendëshme të fshatit, shtrimi i rrugëve të parcelave. Ura te Arti kërkon ndërhyrje. Linja e ekelektrikut është e ulët dhe zënë mjetet e larta duke përbërë rrezik serioz ndaj duhet ndërhyrje urgjente pasi përbën rrezik.



**Krytari i bashkisë  
z. Fatjon Duro**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banor i fshati Zharrëz z. Vladimir Hoxha:** - Problemi kryesor në fshat është ujësjellësi pasi Zharrëza ka vetë dy orë ujë në ditë. Kërkoj të shtohet numri i koshave të plerave, gjithashtu kërkoj të vendosen tubinat pasi disa familje penalizohen duke mos hyrë në tokën bujqësore



**Banor i fshati Zharrëz  
z. Vladimir Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banor i fshatit Zharrëz z. Tajar Hajdini:-** Kërkoj që të ndërhyri lidhur mbi marrjen e masave për zjarret edhe diçka tjetër përse keni vënë pengesa në rrugë në mesin e lagjes dhe përse nuk i keni vendosur atje ku duhet për të ura kalonë makinat me shpejtësi ndaj gjeni vende të sakta për vendosjen e pengesave.




**Banor i fshatit Zharrëz  
z. Tajar Hajdini**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banor i fshatit Zharrëz z. Irfan Belulaj :-** Rruga në lagjen Belulaj kërkon ndërhyrje urgjente pasi nuk është vënë kurrë dorë nga Dalipaj deri të rezervuari. Shtylla e korentit në mesin e lagjes shkarkon energji në shtyllë ndaj kërkoj të ndërhyri për zëvendësimin e saj para se të ndodhë ndonjë fatkeqësi.



**Banor i fshatit Zharrëz  
z. Irfan Belulaj**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banor i njësisë Zharrës z Fuat Bani:-** Kërkojmë ndërhyrje në rrugë pasi është e pakalueshme

**Banor i fshati Zharrë z. Feti Gishti:-** Ju thoni se keni punuar me pastrimin e kanaleve por keni ngatëruar kanalet kullues me ato vaditës pasi atje ku punohet aktualisht për pastrimin e tyre nuk duhet të punohet dhe atje ku ka vërtet nevojë për ndërhyrje nuk ndërhyet.

Nuk kemi ndriçim në fshat dhe as ujë për vaditje. Kërkoj gjithashtu të bëhet hapja e rrugëve të parcelave te argjinatura pasi ka rrjedhje në tokën bujqësore



**Banor i fshati Zharrë  
z. Feti Gishti**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro:-** Stacioni vaditës i Belinës është drejt përfundimit. Ndërsa rruga nga pjesa e lumit do të zgjidhet këtë javë kurse lidhur mbi çështjen e rrugës që sapo thatë patjetër që edhe në zonën tuaj të banimit do të punohet



**Kryetari i Bashkisë  
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banor i njësisë Zharrës z Fuat Bani:-** Kërkojmë ndërhyrje në rrugë pasi është e pakalueshme

**Drejtor Kabineti z.Arben Semanjaku:-** lidhur mbi punimet që kanë mbetur pa u përfunduar mendoj që të sillen mjetet për një javë që të punojnë në të gjithë njësinë me qëllim mbylljen e punimeve emergjente

**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro:-**Aktualisht është duke u punuar në patos pasi ndërhyrjet janë më emergjente atje

**Kryetar i fshatit të Ri z. Bexhet Rredhi:-** Rrugët e fshatit të ri nuk kanë ndriçim, kërkoj pastrimin e rrugëve nga ferrat dhe në këtë mënyrë shmangim edhe zjarret aksidentale si dhe të shikohet mundësia për vendodhjen e koshave të plehrave. Rruga te Feranjakët kërkon ndërhyrje urgjente për hapjen e kanaleve.



**Kryetar i fshatit të Ri  
z. Bexhet Rredhi**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banor i njësisë Zharrëz z. Qazim Toska:-** Problemi im është i lidhur mbi përmbytjen e tokës nga ana e pusit që ka hapur bashkia dhe i gjithë uji depozitohet në tokën time dhe pa rrjedhje të pandërprerë pasi është pus fontanë ndaj të gjendet një zgjidhje



**Banor i njësisë Zharrëz  
z. Qazim Toska**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Anëtar i Këshillit të Bashkisë z. Erald Çepele:-** Aty ka një problem pasi uji që del nga pusi nuk kalon në strugë por derdhet në tokën e qytarit dhe e vetmja zgjidhje është kanalizimi i ujit në strugë

**Banor i njësisë Zharrëz Qazin Toska:-** kjo u bë në mënyrë të qëllimshme pasi u hap një gropë që uji të mos kalojë në strugë por të shkojë në tokën time duke e kthyer në moçal.

**Kryetari i fshatit Frashër z. Iraksi Zarka:-** Përroi i fshatit Frashër ka nevojë për ndërhyrje urgjente për pastrimin e tij

	<p><b>Kryetari i fshatit Frashër z. Iraksi Zarka</b></p> <p><b>Dëgjese publike me temë:</b></p> <p><b>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</b></p> <p><b>Maj 2024</b></p>
---	--

**Drejtor Kabineti z. Arben Semanjaku:-** Është viti i tretë që pastrohet përroi dhe besoj që do të vazhdojë përsëri puna për pastrimin e tij.

**Kryetari i Keshillit z. Armand Ahmetaj:-** Faleminderit nëse ndokush nga të pranishmit ka ndonjë gjë për të shtuar, komente apo sygjerime? Meqenëse jo e konsideroj këtë takim konsultativ të mbyllur. Edhe një herë faleminderit për pjesëmarrjen.

**Konceptoi:**  
**Koordinator i Konsultimit Publik**  
Suzana Hysenaj



**Pranoi:**  
**Sekretar i Këshillit**  
Refaela Xeba





**Tema e Konsultimit: “Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**



